



**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

Republika e Kosovës - Republika Kosova  
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
 Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
 Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

**Kuvendi i Komunës**  
 01 Nr. 01 Nr./Br/2020 352/01-15099  
 Datë: 10.07.2020 14.07.2020  
 Data/Datum

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në nenin 12 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt:10.07.2020 pas diskutimeve lidhur me piken e rendit të ditës : Diskutim mbi Stacionin Transfer të mbeturinave dhe ndotja e ambientit si pasoj e zjarrëvënjeve në këtë deponi, e miratoi këtë:

### D E K L R A T Ë

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës përmes këtij akti deklaron se ndotja e ajrit nga ndezja e mbeturinave në Stacionin Transfer të mbeturinave në Gjakovë ka arritur nivelet më të larta të rrezikshmërisë . Ndezja e mbeturinave ka bërë që komuna e Gjakovës shpeshherë të radhitet si Komuna me ndotjen më të lartë të ambientit .  
 Duke pasur parasysh që shëndeti i qytetarëve tanë është në rrezik , bazuar në kompetencat që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi Kuvendi i Komunës së Gjakovës nxjerrë këto rekomandime :
  1. Të largohen të gjitha mbeturinat nga Stacioni Transfer në afat prej 60 ditësh .
  2. Në mbledhjen e radhës së Kuvendit të prezantohet një plan nga qeverisja komunale për zhvendosjen e stacionit të mbeturinave në largësi të mjaftueshëm nga zonat e banuara .
  3. Në zonën e re transfer për, mbeturinat , të instalohen metoda më moderne të riciklimit dhe të parandalohet deponimi i sasive të mëdha të mbeturinave .
  4. Zona aktuale e Stacionit transfer të mbeturinave të shndërrohet në zonë të gjelbër dhe rekreative për banorët duke pasur parasysh planifikimin afatmesëm të zhvillimit të zonës përreth .
  5. Të trajtohet me prioritet gjetja dhe vënia pranë drejtësisë të zjarrvënësve të mbeturinat nga organet Kompetente .
  6. Të raportohet në baza të rregullta para Kuvendit rreth menaxhimit të Stacionit transfer të Mbeturinave dhe menaxhimin e mbeturinave në përgjithësi .
2. Obligohen organet e administratës Komunale, dhe institucionet tjera përgjegjëse që ti marrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve të cekura më lartë .
3. **Ju dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Drejtorisë për Shërbime Publike .
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala